



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 481/24 Prot.

Koplik më: 16 /04/2025

V E N D I M

Nr 6 , Datë 10 / 04 / 2025

PËR

**DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR (RINOVIM KONTRATE) TË
SIPERFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË MALËSI E MADHE**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 10.04.2025 Bazuar ne urdhërin nr.27 datë 14.02.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira sipas kerkesave , si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/1 nenit 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “ Për Pyjet ”, VKM nr.888 dt.27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve”, Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në perdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.



V E N D O S I :

- I- Dhenien me qira (rinovimin e kontratës nr.4962 datë 06.08.2018) të sipërfaqes prej 0.0166 ha së Shoqësisë Vodafone ALBANIA SH.A për një afat 10 vjecar.
- II- Siperfaqja prej 0.0166 ha të jepet në përdorim (qira) për një afat 10 vjecar me të drejte rinovimi , e cila ndodhet ne ngastrat/nenngastrat 16 a të Ekonomisë Pyjore Kastrat-Zagore .
- III- Vlera totale e dhënies me qira ne vit është 212 690 (dyqindëtdymbëdhjetëmijëegjashtëqindëntëdhjetë) lekë.
- IV- Vlera e përdorimit në vit është 166 000(njëqindëgjashtëdhjetëegjashtëmijë)lekë
- V- Vlera e përdorimit për ndërtim /përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim ,me rrjetin rrugor ekzistues në vit është 46 690 (katërdhjetëegjashtëmijëegjashtëqindëntëdhjetë)lekë.
- VI- Vlerat dhe treguesit e mësipërm bazohen në raportin e hartuar nga strukura përgjegjëse për pyjet pranë Bashkisë Malësi e Madhe , bashkangjitur këtij projektvendimi.
- VII- Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.

Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve.

- VIII- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore“,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 10.04.2025

Vota Pro 24

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 5

Zbardhur me datë 14.04.2025





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 491/₃ Prot.


Koplik më: 25 /03 /2025

PROJEKT -VENDIM

Nr _____, Datë ____/____/ 2025

**PËR
DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR (RINOVIM KONTRATE) TË
SIPERFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË MALËSI E MADHE**

Bazuar ne urdhërin nr.27 datë 14.02.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira sipas kërkesave , si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/1 nenit 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “ Për Pyjet ”, VKM nr.888 dt.27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve”, Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në perdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.




VENDOSI:

Që ti propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe që të miratojë :

- I- Dhenien me qira (rinovimin e kontratës nr.4962 datë 06.08.2018) të sipërfaqes prej 0.0166 ha së Shoqësisë Vodafone ALBANIA SH.A për një afat 10 vjecar.
- II- Siperfaqja prej 0.0166 ha të jepet në përdorim (qira) për një afat 10 vjecar me të drejte rinovimi , e cila ndodhet ne ngastrat/nenngastrat 16 a të Ekonomisë Pyjore Kastrat-Zagore .
- III- Vlera totale e dhënies me qira ne vit është 212 690 (dyqindedymbëdhjetemijëegjashtëqindëntëdhjetë) lekë.
- IV- Vlera e përdorimit në vit është 166 000(njëqindegjashtëdhjetëegjashtëmijë)lekë
- V- Vlera e përdorimit për ndërtim /përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim ,me rrjetin rrugor ekzistues në vit është 46 690 (katërdhjetëegjashtëmijëegjashtëqindëntëdhjetë)lekë.
- VI- Vlerat dhe treguesit e mësipërm bazohen në raportin e hartuar nga strukura përgjegjëse për pyjet pranë Bashkisë Malësi e Madhe , bashkangjitur këtij projektvendimi.
- VII- Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.

Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve.

Faleminderit për mirëkuptimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALESI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 491/Prot.
2

Koplik ,më: 25/03 /2025

Relacion
PËR

MIRATIMIN DHËNIE PËRDORIM /HEQJE NGA FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PËR
INSTALIM ANTENË TË “SHOQËRISË VODAFONE ALBANIA” SH.A. NË NJESINË
ADMINISTRATIVE SHKREL

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 germa c , nenit 54 germa e/1 propozon:

Të nderuar këshilltarë

Bazuar në kërkesen e shoqëria “ Vodafone Albania” sh.a me shkresen ref.prop/004/ht, datë 24.01.2025 ku kërkuar rinovimin e kontratës së qirasë për përdorim të sipërfaqes pyjore për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullor për instalim e Stacion Baze Transmetimi (Bts). Kjo kontratë ka qenë e lidhur për një afat 5 vjeçar.

Më lejoni tu paraqes relacionin për raportin mbi studimin teknik për miratimin e rinovimit të kontratave së qirasë për instalimin të antenës së shoqërisë “Vodafone albania” sh.a. të sipërfaqeve pyjore në ekonominë pyjore Kastrat-Zagore ,ngastra 16/a Njësia Administrative Shkrel ,për dhënien në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqes totale 0.0166 ha, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.

Nga kjo sipërfaqe nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit , funksionin dhe formen e qeverimit dhe treguesit kryesore të ngastrave të ekonominë pyjore Kastrat-Zagore.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullor bazohen VKM nr. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1.datë 09.06.2016 ”Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.



Vlera totale e dhënies me qira ne vit është 212 690
(dyqindedymbdhjetemijëegjashteqindenentedhjetë) lekë.

Vlera e përdorimit në vit është 166 000(njëqindegjashtëdhjetëegjashtëmijë) lekë.

Vlera e përdorimit për ndërtim /përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim ,me
rrjetin rrugor ekzistues në vit është 46 690
(katërdhjetëegjashtëmijëegjashtëqindenëntëdhjetë)lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen VKM nr.559 datë
29.07.2022.

Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko-ekonomik.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

KRYETAR

TONIN MARINAJ

